

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-264 N

VESHJE EPOKSIDE ME STRUKTURË TË LARTË DHE VESHJE IZOLUESE PËR DYSHEME



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-264 N është rrëshirë epokside me ngjyrë dhe me 2 përbërës, e cila mund të ofrojë finiturë me rezistencë ndaj konsumimit, pa fuga, me mirëmbajtje të pakët, finiturë të lëmuar me shkëlqim ose kundër rrëshqitjes kur spërkatet me agregate që kanë granulometri të ndryshme. Trashësia varion midis 0.6-3.0 mm. Për kushte konsumimi mesatar-të rëndë. Për përdorim të brendshëm.

PËRDORIMET

Sikafloor®-264 N duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Sistem me strukturë të lartë për shtrimin e dyshemeve për nënshtresa betoni dhe llaçi me bazë çimentoje me rezistencë normale deri në mesatare ndaj konsumimit si p.sh. dhomat me nivel të lartë higjienë, salla magazinimi, ofiçina, garazhe dhe rampa ngarkimi.
- Veshje izoluese / përfundimtare për sisteme kundër rrëshqitjes me spërkatje rëre, si vendet e parkimit të automjeteve me shumë kate ose nëntokësore, hangarë mirëmbajtjeje dhe zonat ku kryhen përpunime të lagështa si p.sh. industria e ushqimit dhe pijeve.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Higjienik dhe pa bashkime
- Rezistencë e mirë kimike dhe mekanike
- Aplikim i lehtë
- Kundër ujit
- Sipërfaqe përfundimtare me shkëlqim
- Sipërfaqe me rezistencë ndaj rrëshqitjes për t' u përshtatur me kërkesat e klientëve
- Mund të mbushet me rërë për të prodhuar një rrëshirë të vetënivelueshme
- Mirëmbajtje e pakët

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtueshmëri me LEED v4 EQc 2: Materiale me çlirime të ulëta

MIRATIME / STANDARDE

- Certifikatë çlirimi grimcash ISO 14644-1, Deklaratë Kualifikimi CSM – kategoria 3, Fraunhofer IPA Raport Nr. SI 1709-952.
- Certifikatë çlirimi gazesh ISO 14644-8, Deklaratë Kualifikimi CSM – kategoria 6,5, Fraunhofer IPA Raport Nr. SI 1709-952.
- Reagimi në zjarr sipas EN 13501-1, Raport Nr. KBHoch-170619, Hoch Fladungen, Gjermani, maj 2017
- Klasifikimi i reagimit në zjarr sipas EN 13501-1, Raport Nr. KB-Hoch-170625, Hoch Fladungen, Gjermani, maj 2017.
- Markë CE dhe Deklaratë Performance si veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit sipas EN 1504-2:2004, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe testimi i llojit.
- Markë CE dhe Deklaratë Performance si llaç rrëshirë sintetike sipas EN 13813:2002, bazuar në testimin e llojit dhe kontrollin e prodhimit në fabrikë.
- Certifikatë pajtueshmërie për kontaktin e drejtpërdrejtë me ushqimin, Instituti Fresenius, Raport Nr. 3419034-01, Gjermani, nëntor 2017



INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Epoksid	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 23,7 kg
	Përbërësi B	kovë 6,3 kg
	Përbërësit A+B	njësi 30 kg gati për përzierje
	Përbërësi A	fuçi 220 kg
	Përbërësi B	fuçi 177 kg, 59 kg
	Përbërësit A+B	1 fuçi përbërësi A (220 kg) + 1 fuçi përbërësi B (59 kg) = 279 kg 3 fuçi përbërësi A (220 kg) + 1 fuçi përbërësi B (177 kg) = 837 kg
Paraqitja / Ngjyra	Rrëshira - përbërësi A	lëng me ngjyrë
	Forcuesi - përbërësi B	lëng transparent
	RAL 1001, 6021, 7030, 7032, 7035, 7037, 7038, 7040, 7042, 9002 Ngjyra të tjera me porosi. Nën rrezatim të drejtpërdrejtë diellor, mund të ketë pak çngjyrosje dhe ndryshim të ngjyrës; kjo gjë nuk ndikon në funksionin dhe performancën e veshjes.	
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe në temperatura midis +5°C dhe +30°C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.	
Dendësia	Përbërësi A	~1,64 kg/l (DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~1,00 kg/l
	Rrëshira e përzierë	~1,40 kg/l
	Të gjitha vlerat e dendësisë në +23 °C.	
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~100 %	Përbërje epokside me përmbajtje të plotë solidesh sipas metodës së testimit Deutsche Bauchemie e.V. (Unioni Gjerman për Kimikatet e Ndërtimit)
Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim	~100 %	

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore D	~76 (7 ditë / +23 °C)	(DIN 53 505)
Rezistenca ndaj abrazionit	~25 mg (CS 10/1000/1000) (7 ditë / +23 °C)	(DIN EN ISO 5470-1)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	~53 N/mm ² (Rrëshirë e mbushur 1:0,9 me F34) (28 ditë / +23 °C)	(EN196-1)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	~20 N/mm ² (Rrëshirë e mbushur 1:0,9 me F34) (28 ditë / +23 °C)	(EN 196-1)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	> 1,5 N/mm ² (dështim betoni)	(ISO 4624)
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione specifike.	
Rezistenca termike	Ekspozimi*	Nxehtësi e thatë
	I përhershëm	+50 °C
	Afatshkurtër max. 7 ditë	+80 °C
	Afatshkurtër max. 12 orë	+100 °C
	Rezistencë termike afatshkurtër* deri në +80°C ku ekspozimi në kushte lagështie të lartë ose lëngje është vetëm rastësor (pastrim me avull, etj.). *Pa ekspozim të vazhdueshëm kimik dhe mekanik dhe vetëm në kombinim me sistemet Sikafloor® si një sistem me spërkatje rëre me ~3-4mm trashësi.	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet	Ju lutemi lexoni skedën teknike të:	
	Sikafloor® MultiDur ES-15	Sistem veshjeje dyshemeje epokside me strukturë të lartë, me ngjyrë dhe të lëmuar
	Sikafloor® MultiDur ES-21	Sistem dyshemeje epokside të lëmuar dhe me ngjyrë
	Sikafloor® MultiDur EB-12	Sistem veshjeje dyshemeje epokside me ngjyrë dhe me spërkatje rëre
	Sikafloor® MultiDur EB-12 ECC	Sistem veshjeje dyshemeje epokside me ngjyrë kundër rrëshqitjes dhe me spërkatje rëre për nënshtresa të lagështa

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : përbërësi B = 79 : 21 (për peshë)		
Konsumimi	~0,25–0,3 kg/m ² ~0,9–1,2 kg/m ² /mm	Veshje me strukturë të lartë Rrëshirë e vetënivelueshme	
	Këto vlera janë teorike dhe nuk përllogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj. Për informacione të detajuara, lexoni skedat teknike të sistemeve Sikafloor® MultiDur ES-15 dhe Sikafloor® MultiDur ES-21.		
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.		
Lagështia relative e ajrit	80 % max.		
Pika e vesës	Kujdes kondensimin! Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose çngjyrosjes së dyshemesë përfundimtare. Shënim: Temperaturat e ulëta dhe kushtet me lagështi të lartë shtojnë mundësinë e çngjyrosjes.		
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.		
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	≤ 4 % pjesë për peshë përmbajtje lagështie. Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë. Pa rritje të lagështisë sipas ASTM (fletë polietileni).		
Koha e punueshmërisë	Temperatura +10 °C +20 °C +30 °C	Koha ~50 minuta ~25 minuta ~15 minuta	
Koha e maturimit	Temperatura e nënshtresës +10 °C +20 °C +30 °C	Min. 30 orë 24 orë 16 orë	Max. 3 ditë 2 ditë 1 ditë
	Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.		

Produkti i aplikuar gati për përdorim	Temperatura	Qarkullim këmbësorësh	Qarkullim i lehtë këmbësorësh	Tharja e plotë
	+10 °C	~72 orë	~6 ditë	~10 ditë
	+20 °C	~24 orë	~4 ditë	~7 ditë
	+30 °C	~18 orë	~2 ditë	~5 ditë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa e betonit duhet të jetë e qëndrueshme, me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (min. 25 N/mm²) dhe me rezistencë minimale ndaj tërheqjes prej 1.5 N/mm².
- Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa kontaminime si pislëku, vaji, graso, veshje dhe trajtime sipërfaqesh, etj.
- Nënshtresat prej betoni duhet të përgatiten mekanikisht duke përdorur pastrim me rrymë abrazive ose shkriftor për të hequr koren e çimentos (qumësht) dhe për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur të përshtatshme për trashësinë e produktit.
- Pjesët e dala mund të hiqen me bluarje smerilizim.
- Betoni i dobët duhet të hiqet si dhe defektet e sipërfaqes si vrimat dhe boshllëqet duhet të ekspozohen plotësisht.
- Riparimet mbi nënshtresë, mbushja e vrimave / hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes mund të bëhet duke përdorur produktet e përshtatshme nga seria e materialeve Sikafloor®, SikaDur® dhe Sikagard®.
- Pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrifët duhet të hiqet plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose vakuum.

PËRZIERJA

Veshjet

Përpara përzierjes, përzieni mekanikisht përbërësin A. Kur i gjithë përbërësi B të jetë shtuar tek përbërësi A, përzieni vazhdimisht për 3 minuta, derisa të përftohet një miks homogjen. Për të siguruar përzierje të plotë, hidhini materialet brenda një konteineri tjetër dhe përzieni sërish për të përfutur një miks të njëtrajtshëm. Duhet të shmanget përzierja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit.

Rrëshira e vetënivelueshme

Përpara përzierjes, përzieni mekanikisht përbërësin A. Kur i gjithë përbërësi B të jetë shtuar tek përbërësi A, përzieni vazhdimisht për 3 minuta, derisa të përftohet një miks homogjen. Kur përbërësit A dhe B të jenë përzierë, shtoni rërën e kuarcit dhe nëse nevojitet Extender T. Përzieni edhe për 2 minuta derisa të përftohet një miks i njëtrajtshëm. Për të siguruar përzierje të plotë, hidhini materialet brenda një konteineri tjetër dhe përzieni sërish për të përfutur një miks të njëtrajtshëm. Duhet të shmanget përzierja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit.

Veglat e përzierjes

Sikafloor®-264 N (pa spërkatje rëre kuarci) duhet të përzihet plotësisht me mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300–400 rpm) ose pajisje tjetër të përshtatshme. Për përgatitjen e rrëshirës së vetënivelueshme, përdorni mikser me veprim të detyruar ose me kovë

rrotulluese. Nuk duhet të përdoret mikser me rënie të lirë.

APLIKIMI

Ndiqni me kujdes procedurat e instalimit siç përcaktohet në Method Statement, udhëzimet e aplikimit dhe udhëzimet e punimeve të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve në kantier. Përpara aplikimit, konfirmoni përmbajtjen e lagështisë të nënshtresës, lagështinë relative dhe pikën e vesës. Nëse përmbajtja e lagështisë > 4% pjesë për pjesë, Sikafloor® EpoCem® mund të aplikohet si një sistem T.M.B. (temporary moisture barrier, barrierë e përkohshme lagështie).

Prajmer

Sigurohuni se një shtresë e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtresën. Nëse është e nevojshme, aplikoni dy shtresa prajmeri. Aplikoni Sikafloor®-156 / 161 /-160 me furçë, rul ose shkop gome (squeegee). Preferohet aplikim me shkop gome dhe pastaj kalim ruli vertikalisht dhe horizontalisht.

Nivelimi

Sipërfaqet e ashpra duhet të nivelohen në fillim. Prandaj përdorni p.sh. Ilaç nivelues Sikafloor®-156/-161/-160 (lexo skedën teknike të produktit).

Veshje e lëmuar me strukturë të lartë

Sikafloor®-264 N mund të aplikohet me rul me push në drejtim vertikal dhe horizontal.

Finitura e vetënivelueshme

Sikafloor®-264 N derdhet dhe përhapet në mënyrë të njëtrajtshme duke përdorur një mallë të përshtatshme/mallë me gjilpërë në trashësinë e kërkuar.

Kaloni rulin me gjëmba vertikalisht dhe horizontalisht që të largoni shenjat nga aplikimi me mallë dhe ajrin e bllokuar, si dhe për të siguruar një trashësi të njëtrajtshme që të arrihet sipërfaqja përfundimtare e dëshiruar.

Veshja me rërë të spërkatur dhe rezistencë ndaj rrëshqitjes

Aplikoni veshjen fillestare mbi nënshtresë dhe spërkasni me rërë kuarci me tepri për të krijuar një profil të njëtrajtshëm sipërfaqeje. Lëreni shtresën të thahet fillimisht dhe hiqni të gjithë rërën e tepruar me fshesë thithëse. Aplikoni një veshje izoluese përfundimtare të Sikafloor®-264 N. Për aplikim mbi nënshtresat e lagështa, lexoni skedën teknike të sistemit Sikafloor® MultiDur EB-12 ECC për ndryshimin e prajmerit ose produkteve për nivelim.

Veshja izoluese

Aplikoni një veshje përfundimtare/izoluese të Sikafloor®-264 N me shkop gome (squeegee) me konsumim 0.6 - 0.8 kg/m² për të mbuluar plotësisht rërën. Në vazhdim kaloni rulin me push vertikalisht dhe horizontalisht.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

Për të ruajtur paraqitjen e dyshemesë pas aplikimit, nga Sikafloor®-264 N duhet të hiqen menjëherë të gjitha derdhjet dhe duhet të pastrohet rregullisht duke përdorur furçë rrotulluese, pastrues mekanik me furçë të ashpër dhe tharës, larës me presion të lartë, teknika larjeje dhe vakuumi, etj., duke përdorur detergjent dhe dyll të përshtatshëm.

DOKUMENTA SHITESË

- Sika® Method Statement: VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE
- Sika® Method Statement: PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE
- Sika® Method Statement: Sikafloor® - REGJIMI I PASTRIMIT

KUFIZIME

- Përpara se të aplikoni Sikafloor®-304 W/-305W/-2540 W mbi Sikafloor®-264 N sipërfaqja duhet të përgatitet me smerilizim.
- Mos aplikoni mbi nënshtresa me lagështi në ngritje.
- Mos spërkasni plotësisht prajmerin me rërë kuarci.
- Sikafloor®-264 N i sapoaplikuar duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Për zona me ekspozim të kufizuar dhe nënshtresa betoni me absorbueshmëri normale, nuk nevojitet lyerja me prajmerin Sikafloor®-156/-161/-160 për sistemin e lyerjes me rul ose veshjet me teksturë.
- Për veshje me rul / teksturë: Nënshtresat e pabarabarta si dhe gjithashtu përfshirjet e papastërtisë nuk mund dhe nuk duhet të mbulohen me veshje të holla izoluese. Kështu që, nënshtresa dhe sipërfaqet e afërta duhet gjithmonë të përgatiten dhe të pastrohen plotësisht përpara aplikimit.
- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në kohë të reduktuar shërbimi dhe plasaritje reflektive.
- Për përshtatje të saktë të ngjyrës, sigurohuni se Sikafloor®-264 N është aplikuar në secilën sipërfaqe nga i njëjti numër serie prodhimi (batch number).
- Në kushte të caktuara, ngrohja nën dysheme ose temperatura e lartë e ambientit kombinuar me ngarkesën e lartë pikësore, mund të lëjnë shenja mbi rrëshirën.
- Nëse kërkohet ngrohje, mos përdorni gaz, vaj, vajguri ose lëndë djegëse fosile të tjera, pasi këto produkte kanë sasi të madhe CO₂ dhe avujsh uji H₂O, të cilët mund të ndikojnë negativisht tek finitura e dyshemesë. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike ventilimi ajri të ngrohtë.
- Konsumimi i veshjes izoluese / përfundimtare varet nga granulometria e rërës.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / j lloji sb) është 500 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja maksimale e Sikafloor®-264 N është < 500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-264 N

Shtator 2019, Botimi 05.01

020811020020000157

Sikafloor-264N-sq-AL-(09-2019)-5-1.pdf

